



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2023:270521
Datë: 23.12.2024
Numri i dokumentit: 06639337

K.DH.SH.II.nr.490/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “City Design Group” shpk, me NUI 811468596 me seli ne Kodra e Diellit rr.”Hilmi Rakovica” nr.12, përfaqësuar nga Alban Makolli avokat nga Prishtina rr.”Muharrem Fejza” Hyrja F nr.4, kundër debitorit “DT Mining” shpk, me NUI 811287350, me seli ne Obiliq Caravodicë rr. “Minierat”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.300/23 dt.27.11.2023, me datën 23.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit “City Design Group” shpk, me NUI 811468596 me seli ne Kodra e Diellit rr.”Hilmi Rakovica” nr.12, përfaqësuar nga Alban Makolli avokat nga Prishtina rr.”Muharrem Fejza” Hyrja F nr.4, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.300/23 dt.27.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.300/23 dt.27.11.2023, ne pjesën e I te dispozitivit te aktvendimit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “DT Mining” shpk, me NUI 811287350, me seli ne Obiliq Caravodicë rr. “Minierat” dhe ka anuluar Urdhrin përmbartimor P.nr.614/22 dt.09.12.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj, për pjesën e detyrimit ne shumen prej 1,416.00 euro dhe ka përfunduar procedurën përmbartimore për këtë pjese te detyrimit. Ne pjesën II te dispozitivit te aktvendimit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit “DT Mining” shpk, me NUI 811287350, me seli ne Obiliq Caravodicë rr. “Minierat” dhe ka lënë ne fuqi Urdhrin përmbartimor P.nr.614/22 dt.09.12.2022 te lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj sa i përket shumës se detyrimit prej 1,555.00 euro se bashku me kamatën ligjore sipas normës se interesit prej 8% dhe shpenzimet e përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, shkeljes së ligjit për procedurën përmbartimore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta ndryshojë për pjesën e I të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor ndërsa pika II e dispozitivit të aktvendimit të mbetet e pandryshuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “City Designx Group” shpk, me NUI 811468596 me seli në Kodra e Diellit rr.”Hilmi Rakovica” nr.12, më datën 09.12.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “DT Mining” shpk, me NUI 811287350, me seli në Obiliq Caravodicë rr. “Minierat”, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr. F-20-12-196 dt.25.12.2020 dhe F-17 dt.02.02.2022. Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj Prishtinë, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.614/22 dt.09.12.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit sipas këtij urdhri në emër të borxhit nga faturat t’i paguaj shumën prej 2,971.38 euro, me kamatëvonesë prej 8% duke llogariturës kur faturat janë bere të arritshme si dhe shpenzimet e përmbartimit.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 15.02.2023, duke e kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se kreditori ka paraqitur fatura pa i kryer shërbimet e tij, faturat e paraqitura nuk janë dokumente të besueshme andaj propozon që gjykata e shkallës së parë ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta anuloj dhe propozimin për përmbartim ta refuzoj si të pabazuar.

Përgjigje ndaj prapësimit të debitorit ka ushtruar kreditori me datën 20.02.2023, me të cilin kundërshton prapësimin e debitorit me arsyetimin se pretendimet në prapësim nuk janë të bazuara sepse kreditori i ka kryer shërbimet në tërësi për çka debitori edhe pjesërisht e ka përmbushur detyrimin nga faturat, se faturat janë pranuar nga debitori, janë deklaruar para organeve kompetente dhe i plotësojnë të gjitha kushtet për përmbartim, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi ndërsa kërkon shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.300/23 dt.27.11.2023, me të cilin e ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit gjykata duke analizuar çështjen dhe provat

ne lende i është referuar nenit 29 par.1, nenpar.1.3 dhe par.3 si dhe nenit 37 te LPP, duke vendos si ne pjesën e parë te dispozitivit ta aktvendimit sa i përket faturës F-17 dt.02.02.2022 pasi fatura e lartcekur nuk plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm ne kuptim te dispozitave te lartcekura sepse e njëjta nuk përmban nënshkrimin e debitorit ndërsa nga shkresat ne lëndë nuk ka prova qe dëshmojnë se fatura është pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori pa u kundërshtuar, fatura nuk ka tipare te përmbarueshmërise pasi është lëshuar njëanshëm nga kreditori prandaj ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka përfunduar pjesërisht procedurën e përmbarimit. Gjykata ka vendos si ne pjesën e dytë te dispozitivit te aktvendimit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor duke vlerësuar se fatura F-20-12-196 dt.25.12.2020 ne shumen prej 1,555.38 euro mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarimi plotëson kushtet për te qenë dokument i besueshëm dhe i përmban te gjitha elementet e kërkuara ne përputhje me nenin 29 dhe 37 te LPP pasi ne të janë treguar te dhëna për palët, shërbimet, pastaj e njëjta është e pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori dhe ka nënshkrimin e tij, po ashtu gjykata ka vendos konform nenit 382 te LMD duke vlerësuar faktin se debitori ka rënë ne vonesë për përmbushjen detyrimit prandaj kreditorit i takon e drejta ne kamatëvonesë nga dita kur fatura është bërë e arritshme e deri ne pagesën definitive. Andaj bazuar ne këto arsye ka vendos si ne dispozitiv te aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave nr. F-20-12-196 dt.25.12.2020 dhe F-17 dt.02.02.2022, te cilat janë lëshuar nga kreditori. Mirëpo edhe për ketë gjykatë gjendja faktike konsiston me atë te konstatuar nga gjykata e shkalles se parë sepse nga shkresat e lendes rezulton se fatura F-17 dt.02.02.2022 nuk plotëson kushtet ligjore te parapara me dispozita ligjore nga neni 29 dhe 37 te LPP sepse e njëjta nuk është e nënshkruar ose edhe e vulosur nga debitori dhe si e tillë nuk konsiderohet se është pranuar ne mënyrë te rregullt nga i njëjti, ndërsa ne shkresat e lëndës nuk rezulton me ndonjë provë se është pranuar ne ndonjë mënyrë tjetër nga debitori, nga rezulton se faturë nuk është e përshtatshme për ekzekutim dhe se me te drejte gjykata e shkalles e pare ka vendos konform nenit 12 par.2 te Ligjit 05/L-118 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore për përfundim te pjesshëm te urdhrin përmbarimor.

Ndërsa sa i përket pjesës se dytë te dispozitivit edhe kjo gjykatë gjënë se fatura F-20-12-196 dt.25.12.2020 e mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarimi i plotëson kushtet ligjore te parapara me dispozitat e nenit 29 par.3 dhe nenit 37 te LPP për te qenë dokument i besueshëm sepse e njëjta propozimit për përmbarim i është bashkangjitur e nënshkruar nga debitori dhe ne origjinal me çka konsiderohet se është pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori, përmban te dhëna te mjaftueshme për palët, shumen e detyrimit afatin e pagesës, pra ka te gjitha tiparet e një dokumenti te besueshëm ashtu qe është e përshtatshme për ekzekutim.

Kjo gjykatë analizoi pretendimet ankimore të kreditorit se për pjesën e atakuar në rastin konkret aktvendimi i shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore dhe vërtetim të gabuar të fakteve por kjo gjykatë i vlerëson si të paqëndrueshme këto pretendime pasi janë vetëm deklarative dhe të paargumentuara, ashtu që si të tilla i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.490/24, me datë 23.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova